



Republika e Kosovës
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Në bazë të nenit 8 dhe 10 paragrafi 6 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, si dhe kërkesës Nr.02/26140 të datës 01.09.2026 së Drejtorisë për Shëndetsi dhe Mirëqenie Sociale – Shtëpia Rezidenciale, Komuna e Kamenicës bënë këtë:

SHPALLJE PUBLIKE

Për plotësimin e pozitës për kryerjen e detyrave specifike
(Procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit)

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- Shtëpia e Komunitetit

Titulli i pozitës: Një (1) Ndihmës Infermiere

Nr. i ekzekutuesve: (1) ekzekutues

Orar i punës : 40 në javë

Paga bruto mujore: 550 €.

Lloji i kontratës; (Punë dhe Detyra Specifike)

Periudha e angazhimit: (120 ditë).

Detyrat Kryesore:

- Bënë kujdesin e përgjithshëm ndaj rezidentit (të varur gjysm të varur dhe të pavarur).
- I pastron flokët dhe fëtyrën, prenë thonjtë bën ndërrimin e ndërresave të shtratit.
- Bën rregullimin e shtartit dhe punët tjera të përcaktuara me rregulloren mbi punën me rezident. I ushqen klientët e varur dhe gjysm të varur.
- Bashkëpunon me motrat medicinale dhe ndihmon gjatë intervenimeve tekniko-medicinale. Kujdesët dhe përgjigjet për pastërtinë e ndërresave personale të shtratit.
- Përgjigjet për higjienën dhe pastërtinë e rrethit ku gjendet si dhe mjetet për ushqimin e rezidentit.
- I bartë ndërresat e pa pastërta të rezidentit në lavendari dhe merret me pastrimin e rrobave dhe mbulojave të ndryshme.
- Bën tretmanin higjienik të rezidentit dhe përgaditjen e kujdesit të rezidentit të vdekur në bashkëpunim me infermieren.
- Merrë klientin në shëtitje, në salon, në dhomë për qëndrim ditor, në park etj.
- Përgjigjet për inventar në repart dhe mjetet tjera të besuara, bën edhe punë të tjera sipas nevojës dhe urdhrit të menaxherit.

Kualifikimi: Shkolla e Mesme

Përvoja e punës: E dëshirueshme

Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartë cekur duhet t'i komplotoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm (kopje) si vijon:

Formulari për punësim i plotësuar;

Dëshmi të kualifikimit arsimor

Dëshmi mbi përvojën e punës (nese ka)

Dokumentin e identifikimit

Dokumenti që nuk është nën hetime nga Gjykata (jo më i vjetër se 6 muaj)

Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në Qendrën për Shërbime me Qytetarë në Administratën Komunale në objektin e Komunës së Kamenicës.

Afati i aplikimit është 7 ditë, nga dita e shpalljes publike në Web faqen Komunale dhe tabelën e shpalljeve.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike lokale”.

Intervista do të mbahet në menyre Verbale (me gojë)

Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët e përfshirë në listën e ngushtë mbi bazën e kriterëve të shpalljes Publike.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, refuzohen.

Kadi RAHIMAJ
Kryetar, Komunës Kamenicës